

W 3521 Prot
A. 25.05.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 13035/10180 Rregj.Them.
Data Regjistrimi 23.11.2015

Nr. 1021 (86-2016-248)Vendimi
Datë 06.05.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 06.05.2016, shqyrtoi në seancë gjyqësore çështjen administrative me palë :

PADITËSE: Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër

IPADITUR: Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të
Tatimeve
Qendra Balneare Peshkopi
Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë

OBJEKTI: Anullimin e Vendimit nr. 30367/4 prot. datë 03.03.2015 të Drejtorisë së
Apelimit Tatimor, vendim i cili ka shfuqizuar pjesërisht aktin
administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor nr. 7064 prot, datë 16.10.2014
të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër.

BAZA LIGJORE: Neni 31 K.Pr.Civile; neni 7/a, 11, 15, 16, 17, 18, 21 të ligjit nr.
49/201 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative
dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji nr. 9920/2008
"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar;
Udhëzimi nr. 24/2008 Për procedurat tatimore në Republikën e
Shqipërisë" i ndryshuar; ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi
të Ardhurat" i ndryshuar, Ligji nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për tatimin
mbi vlerën e shtuar"; Kodi i Procedurave Administrative në Republikën
e Shqipërisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 4087 (80-2015-2401) datë 20.07.2015 ka vendosur :

1. *Rrëzimin e padisë së paraqitur nga paditësi Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
2. *Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër duke parashtruar se:

1. Gjykata gjatë gjykimit nuk ka bërë një hetim të plotë të fakteve, por është mjaftuar në përmbajtjen e pjesës arsyetuese të DAT Tiranë, gjykata nuk ka provuar se ku e mbështet DAT arsyetimin e saj. Pala e paditur nuk provon pretendimet e saj në lidhje me detyrën e agjentit tatimor për vjeljen e tarifave "larjes". Gjithashtu në kushtet e mosparaqitjes të dokumentacionit të vendimit të këshillit bashkiak ndaj palës së paditur është vendosur masa e gjobës, për mosdhënie informacioni.
2. Gjykata nuk ka bërë një hetim të plotë të provave në gjykim, madje gjykata ka kryer vlerësimin e saj mbi prova të cilat nuk janë paraqitur në gjykim, duke i marrë ato të mirëqena.
3. Sa i përket tatim fitimit nga ana e DAT është vendosur shfuqizimi i detyrimeve të vlerësuar, me arsyetimin se subjekti ankues nuk ka realizuar të ardhura nga mbledhja e tarifës, këto të ardhura janë për llogari të Bashkisë Peshkopi. Gjykata në arsyetimin e saj është mbështetur pikërisht në arsyetimin e DAT Tiranë duke vlerësuar se nuk ka të ardhura nga mbledhja e tarifës. Në këto kushte arsyetimi që ka bërë gjykata është jo korrekte dhe jo profesionale, pasi gjykata në mënyrë evidente ka shkelur ligjin material dhe procedural, duke u mjaftuar në pjesën arsyetues vetëm me argumentimet që janë bërë me vendimet e DAT, argumentime të cilat janë ekstra ligjore dhe të pabazuara në fakte dhe prova.
4. Qendra Balneare është vlerësuar nga DRT Dibër, sepse janë kryer konstatime se në llogarinë e saj bankare ka diferenca shtesë ndërmjet deklarimit dhe gjendjes në bankë, diferenca për të cilat nuk janë lëshuar fatura me tvsh, pra të pa deklaruar në kuptim të legjislacionit tatimor, në këto kushte subjekti nuk është penalizuar për shkak të interpretimit të "tarifës vendore" të vendosur nga Bashkia Peshkopi.
5. Gjykata në kundërshtim me ligjin, faktet dhe provat në gjykim, gjatë vlerësimit të saj bën një përsëritje të argumenteve të kryera nga DAT Tiranë, gjatë shqyrtimit të ankimit. Gjithashtu i është deklaruar gjykatës se diferenca shtesë në bankë janë shuma të padeklaruara, të paflektuara në asnjë dokument kontabël dhe me të drejtë DRT Dibër ka vlerësuar si të ardhura të padeklaruara.
6. Paditësi në ankimin e tij pretendon se Drejtoria e Apelit Tatimor ka gabuar kur ka vlerësuar tatimin mbi vlerën e shtuar për të cilën argumenton se këto diferenca të ardhura në bankë janë furnizim i tatueshëm, pra furnizim për shitjen e shërbimeve që ofron Qendra Balneare. Gjithashtu nëse i referohemi po të njëjtës bazë ligjore mbi të cilën referon dhe DAT Tiranë, pikërisht "SNK 8" sa i përket diferencës mbi të ardhurat përcakton se: Të ardhurat janë përfitime ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës

- kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto veprime çojnë në rritjen e kapitalit, burimi kryesor është shitja e mallit dhe kryerja e shërbimeve. Gjykata nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga DRT Dibër por është mbështetur në arsyetimin e DAT.
7. Gjykata ka keqinterpretuar ligjin në lidhje me arsyetimin mbi "Tatimin në burim", DRT Dibër vlerëson tatimin në burim për disidentët kur ato shpërndahen ose kur shoqëria nuk përcakton destinacionin e fitimit, gjë që në rastin konkret, sipas parashtrimeve të DAT, nuk ka ndodhur, pasi fitimi nga Qendra Balneare ishte destinuar të përdorej për investime për rikonstruksion. Për këtë detyrim gjykata ka vlerësuar se DAT ka vlerësuar drejtë dhe vendimi i saj është një akt administrativ i vlefshëm dhe i nxjerr në përputhje me ligjin, por paditësi parashtron se gjykata në arsyetimin e saj është treguar jo korrekte në lidhje me vlerësimin e dividendëve, duke mbajtur të njëjtin qëndrim që ka mbajtur DAT Tiranë.
 8. Paditësi parashtron se ka paraqitur në gjykatë të gjitha provat që kundërshtojnë qëndrimin e mbajtur për shfuqizimin e vendimit të DRT Dibër, mbi tatimin në burim. Konkretisht shprehet se shoqëria ka rritur zërin ndërtesë për vitin 2009, por nuk ka deklaruar nga ana e shoqërisë shtimin e zërit ndërtesë, nuk janë paraqitur fatura apo autofatura që kanë të bëjnë me kryerjen e investimit. Gjithashtu gjykata gabon kur deklaron se tërheqja e shumës 8030636 lekë është kryer për rikonstruksionin e objektit. Si provë në gjykatë DRT Dibër ka paraqitur dhe librat e shitjes së shoqërisë "Selami" sh.p.k e cila pretendohet se do të kryente rikonstruksionin.
 9. Paditësi në ankimin e tij ka parashtruar se gjykata gabon kur i referohet në arsyetimin e saj vendimit Nr. 6, të Këshillit Drejtues të Qendrës Balneare, pasi një vendim i tillë nuk është paraqitur si provë në gjykim as dhe gjatë procesit administrativ. Gjithashtu DRT Dibër pretendon se gjykata as nuk ka verifikuar nëse ka një këshill drejtues pranë palës së paditur.
 10. Paditësi pretendon jo vetëm pasaktësi të DAT por dhe të gjykatës gjatë vlerësimit të detyrimeve të palës paditëse. Në arsyetimin e DAT shprehet se investimi është kryer nga Bashkia Peshkopi në bashkëpunim me Qendrën Balneare dhe shoqëria për kryerje të punimeve është "Selami". DAT nuk ka deklaruar në lidhje me paraqitjen e situacionit të punimeve, të cilën pala e paditur nuk e paraqiti asnjë herë gjatë kontrollit, gjithashtu nuk sqarohen instrumentet ligjore të bashkëpunimit midis Bashkisë Peshkopi dhe shoqërisë. Gjithashtu pala paditëse parashtron se nuk ka fatura tatimore të prera nga shoqëria "Selami" për sa kohë është kjo shoqëri që ofron punë. Pala paditëse DAT në ankimin e saj ngre pretendimin se shoqëria e cila ka kryer realizimin e punimeve nuk ka lëshuar asnjë faturë tatimore gjatë vitit tatimor 2008 – 2009.
 11. Gjykata gjatë procesit gjyqësor nuk është shprehet nëse ka ndonjë vendim të asamblesë së ortakve për destinacionin e fondeve të vitit 2008 dhe nëse është disponuar sipas ligjit në organet kompetente.
 12. Pala paditëse pretendon se gjatë shqyrtimit të procesit gjyqësor nuk është paraqitur në cilësinë e provës faturat e shitjes nga subjekti kontraktues, për kryerjen e rikonstruksionit. Gjithashtu pretendohet se nuk provohet likuidimi i këtyre faturave, ndaj subjektit kontraktues.

Për sa më lartë paditësi DRT Dibër parashtroi se ndodhur në kushtet e shkeljeve të rënda të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatës, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural, në zbatim të nenit 50/1 vendosi të kalojë çështjen në seance gjyqësore, për një sqarim të rrethanave dhe fakteve si dhe për të dëgjuar pretendimin e palëve në proces.

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi duke kërkuar:

Anullimin e Vendimit nr. 30367/4 prot. datë 03.03.2015 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, vendim i cili ka shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ. Njoftim Vlerësimi Tatimor nr. 7064 prot, datë 16.10.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime i ka referuar si bazë ligjore Neni 31 K.Pr.Civile; neni 7/a, 11, 15, 16, 17, 18, 21 të ligjit nr. 49/201 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Udhëzimi nr. 24/2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, Ligji nr. 7928 datë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 4087 (80-2015-2401) datë 20.07.2015 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin. Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 4087 (80-2015-2401) datë 20.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

Qendra Balneare Peshkopi është person juridik i regjistruar pranë QKR-së dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër me Numër Identifikues NIPT J 97005702A, i cili ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Peshkopisë.

Pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, ka ushtruar kontroll pranë shoqërisë "Qendra Balneare" sipas programit për kontroll me nr. 1345 prot, datë 08.03.2013.

Në përfundim të këtij kontrollit të kryer nga inspektorët në datën 14.10.2014 është mbajtur "Raport Kontrolli", nga ana e palës paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër e cila ka informuar shoqërinë nëpërmjet shkresës nr. 7065, datë 16.10.2014. Menjëherë pas komunikimit të raport kontrollit përfundimtar, DRT Dibër ka gjeneruar "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 7064 prot, datë 16.10.2014, sipas të cilit pala e paditur Qendra Balneare duhet të paguante detyrimin tatimor në shumën totale 4.344.380 lekë, për shkak se nga ana e kësaj të fundit ka pasur mos deklaram të saktë të TVSH për vitet 2009 – 2012 si dhe tatim fitimit për vitet 2008-2011, tatimi në burim 2009-2012 si dhe gjoba për mosmbajtje të saktë të dokumentacionit.

Kundër këtij Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore ka paraqitur ankim pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, pala e paditur Qendra Balneare. Drejtoria e Apelit Tatimor (DAT) me vendimin nr. 30367/4 prot datë 03.03.2015 ka vendosur shfuqizimin pjesërisht të Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 7064 prot. datë 16.10.2014.

Referuar vendimit të DAT Tiranë, rezulton se ankimi për detyrimet tatimore është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore neni 106 dhe 107 të ligjit 9920/2008 si dhe udhëzimit nr. 24/2008, ka rezultuar se ankimi është kryer brënda afatit 30 ditor dhe pala ankuese ka kryer pagesën e detyrimeve objekt ankimi, kjo nëpërmjet garancisë Bankare nr 414, datë 19.11.2014. Gjatë shqyrtimit të kërkesë ankimore, DAT pasi kërkoi plotësimin e akteve objekt ankimi si dhe pas kryerjes së takimit zyrtar për të sqaruar specifikat e ankimit, në përfundim DAT Tiranë, ka vendosur:

1. Shfuqizimin e aktit "Njoftim vlerësimi për detyrimet Tatimore" nr. 7064, datë 16.10.2014 për detyrimet dhe gjobat të nxjerra nga DRT Dibër si më poshtë:

- Tatim Fitimi për vitin 2009, ulje gjendje kreditore 121,295 lekë dhe gjoba në masën 121,294 lekë.
- Tatim Fitimi për vitin 2010, ulje gjendje kreditore 177,132 lekë dhe gjoba në masën 177,132 lekë.
- Tatim Fitimi për vitin 2011, ulje gjendje kreditore 52,794 lekë dhe gjoba në masën 52,794 lekë.

Për heqjen e këtyre detyrimeve DAT Tiranë ka arsyetuar si më poshtë vijon:

Drejtoria Apelit Tatimor shfuqizon këtë vlerësim të kryer si dhe gjobat mbi të, pasi subjekti nuk ka realizuar të ardhura nga mbledhja e tarifës e cila është mbledhur për llogari të Bashkisë Peshkopi. Kjo tarifë e mbledhur për llogari të kësaj bashkie e cila i është caktuar Qendrës Balneare me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe i kërkohet sipas Akt Detyrimit për taksat dhe tarifatat Vendore. Në bazë të Akt Marrëveshjes date 23.02.2009 të lidhur mes Bashkisë Peshkopi dhe Qendrës Balneare në të cilën është përcaktuar:

Në pikën 1 të marrëveshjes tarifa për çdo të shtruar në hotelin e Qendrës dhe ato private në shumën 35.7 lekë për larje .

Në pikën nr 2 të marrëveshjes Qendra është cilësuar agjent i mbledhjes dhe derdhjes së kësaj tarife në Bashkinë Peshkopi.

Në pikën 3 është përcaktuar se Qendra do të zbatojë këtë marrëveshje dhe në vitet në vazhdim dhe nuk përfiton vetë nga shuma e arkëtuar.

Sipas Ligjit nr 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 19 i "Fitimi i tatueshëm" ,në të cilin është përcaktuar: Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore

përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qellim.

Sipas SNK 8 "Të Ardhurat" paragrafi 13 është përcaktuar se: "Të ardhurat përbëhen nga përfitimet ekonomike bruto, të marra nga njësia ekonomike raportuese për llogari të saj. Shumat e mbledhura, në emër të palëve të treta, të tilla si tatimi mbi vlerën e shtuar, nuk janë të ardhura. Në të njëjtën mënyrë, shumat bruto, të mbledhura nga agjencitë dhe marrëveshjet e komisioneve, nuk janë të ardhura, por vetëm komisione të fituara nga këto Marrëveshje."

Sa më sipër DAT Tiranë, ka vendosur shfuqizimin e detyrimit për tatim fitimin e viti 2009 në vlerën 121.294 lekë dhe gjoba 100%, në vitin 2010 në vlerën 169.506 lekë dhe gjoba 100%, në vitin 2011 në vlerën 53.995 e gjoba 100% si dhe në vitin 2012 në vlerën 206.198 dhe gjoba 100%.

2. Nga kontrolli ka rezultuar se janë vendosur detyrime përsa i përket tatimit në burim për vitin 2009 në vlerën 803,064, detyrim që së bashku me gjobat dhe kamat vonesën arrin në detyrimin total 1,243,946 lekë.

DAT Tiranë në përfundim të shqyrtimit të ankesës së kryer si dhe në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur rezulton të jetë shprehur se detyrimi i përcaktuar sa më lartë nuk është i drejtë. Në arsyetimin e saj DAT i është referuar vendimit nr 6, datë 20.06.2008 të Këshillit Drejtues të subjektit "Qendra Balneare Peshkopi", me të cilin është vendosur të kryej "Rikonstruksionin e kompleksit Balnear".

DAT Tiranë në shqyrtimin administrativ të ankimit ka vlerësuar se shoqëria ka vepruar në përputhje me ligjin nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 33/1 dhe 2. Në vështrim të këtij neni DAT Tiranë sqaron se *"Shoqëritë tregtare kanë detyrimin për të miratuar në asamblenë e ortakeve rezultatet financiare të vitit pasardhës duke destinuar tatimin mbi fitimin. Ky destinim është i kufizuar në tre kategori: përcaktimin e rezervave ligjore, përcaktimin e shumes për investim apo shtesë kapitali si dhe shpërndarje dividendi"*. Nëse tatimpaguesi nuk ka zbatuar dispozitat e mësipërme, administratës tatimore i lind e drejta e vlerësimit, duke e konsideruar shumën e padestinuuar si shpërndarje dividendi.

DAT ka vlerësuar se tatimi mbi dividendin mbahet në rastet kur merret vendimi për shpërndarjen e këtij dividendi, si dhe në rastet kur shoqëria nuk përcakton destinimet sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 33/1.

Për sa më lartë DAT Tiranë ka vendosur shfuqizimin pjesor të detyrimeve të vendosura nga DRT Dibër.

Në këto kushte DRT Dibër duke mos qënë dakord me vendimin e marrë nga DAT Tiranë i është drejtuar në datën 07.04.2015 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në shqyrtim të çështjes me kërkesë padinë me objekt, dhe palë sikurse përcaktohen në pjesën hyrëse të vendimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 4087 (80-2015-2401) datë 20.07.2015 ka vendosur rrëzimin padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 4087 (80-2015-2401) datë 20.07.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

Vlerësimi i gjykatës për sa i përket përcaktimit të detyrimeve për "Tatim fitimin",

1. Gjykata ka vlerësuar se Drejtorisë së Apelimit Tatimor, në shqyrtimin e ankimit administrativ të shoqërisë Qendra Balneare, ka shfuqizuar njoftim vlerësimit tatimor në zërin përkatës "Tatim Fitimi" me arsyetimin se nuk ka realizuar të ardhura nga mbledhja e tarifës së "larjes", pasi kjo tarifë është mbledhur për llogari të Bashkisë Peshkopi. Në kushtet kur nuk ka siguruar të ardhura, nuk mund të penalizohet për pagimin e tatim-fitimit.
2. Gjykata në arsyetimin e saj i është referuar përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" si dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 (SNK8), paragrafi 13 "*shumat e mbledhura në emër të palëve të treta, nuk janë të ardhura*". Në këto kushte, mbledhja e tarifës nga Qendra Balneare për llogari të Bashkisë Peshkopi nuk mund të konsiderohet si e ardhur për këtë subjekt, pra nga mbledhja e këtyre tarifave ky subjekt nuk gjeneron të ardhura për llogari të tij.
3. Gjykata në arsyetimin e saj është shprehur se DAT Tiranë ka vlerësuar me të drejtë situatën dhe shfuqizimin e vlerësimit të kryer për zërin "tatim fitim" në vitet 2009, 2010, 2011, vendim i marrë në përputhje të plotë me rrethanat e faktit dhe me ligjin, pra nuk mund të ngarkohet një subjekt më detyrim, për shumat e mbledhura në interes të palëve të treta.

Vlerësimi i gjykatës për përcaktimin e detyrimit të "Tatimit në Burim":

1. Për sa i përket vlerësimit të kryer për tatim, nga ana e Drejtorisë së Apelimit Tatimor, është vendosur shfuqizimi i këtij vlerësimi, me arsyetimin se subjekti ankues në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 6 të Qendrës Balneare është vendosur të kryhej "Rikonstruksioni i Kompleksit Balnear" në vlerën e preventivuar në shumën 23.119.200 lekë ku nga ana e Qendrës Balneare do të financohej 8.380.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër do të financohej nga "Programi për fuqizimin e qeverisjes vendore në Qarkun Dibër". Nga ana e Drejtorisë së Apelimit Tatimor, është vlerësuar se Qendra Balneare ka vepruar në përputhje me nenin 33/1 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat".
2. Në vijim të sa më sipër, gjykata ka çmuar se vlerësim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor është i bazuar në ligj, pasi siç është sqaruar edhe në nenin e sipërcituar, shoqëritë tregtare kanë detyrimin për të miratuar në asamblenë e ortakëve rezultatet financiare të vitit paraardhës duke destinuar fitimin pas tatimit. Ky destinim mund të bëhet në tre drejtime: në përcaktimin e rezervave ligjore; në përcaktimin e shumës për investime apo shtesë kapitali, si dhe shpërndarje dividendi.
3. Nga ana e Qendrës Balneare shuma e përcaktuar si e padestinuar dhe për të cilën nuk ishte paguar tatimi në burim sipas pretendimeve të palës paditëse, ishte destinuar në fakt të përdorej për investime për rikonstruksionin e Kompleksit Balnear. Për pasojë, shfuqizimi i vlerësimit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor për "tatimit në burim", është vendosur në përputhje të plotë me ligjin, pasi "tatimi në burim" mbahet vetëm në rastin e shpërndarjes së dividendit ose kur shoqëria nuk përcakton destinimin e fitimit, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur dhe ka pasur një destinacin të caktuar në zërin investime.

4. Sa më sipër gjykata ka vlerësuar se Vendimi nr. 30367/4 prot. datë 03.03.2015 i Drejtorisë së Apelit Tatimor është një akt administrativ i vlefshëm dhe i nxjerrë në përputhje me ligjin. Në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, Drejtoria e Apelit Tatimor, me aktin administrativ të sipërcituar ka vendosur të shfuqizojë pjesërisht Njoftim Vlerësimin nr. 7064 prot. datë 16.10.2014 të DRT Dibër, bazuar në nenin 108 paragrafi i 3-të, gërma "c" në të cilën parashikohet:
- "Drejtoria e apelit, pas shqyrtimit të ankimit, vendos: c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin".*
5. Gjykata ka vlerësuar se akti administrativ objekt gjykimi është i mirë arsyetuar në përputhje edhe me nenin 108 paragrafi i 1, gërma "b" dhe neni 109 paragrafi i 1, i Kodit të Procedurave të Administrative.

Në përfundim të gjykimit në themel gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, objekt ankimi, të akteve të dosjes, si dhe në referim të dispozitave të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 4087, datë 20.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural.

Megjithatë ky vendim është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material që është i zbatueshëm në rastin konkret, e si i tillë ky vendim duhet të ndryshohet dhe kërkesë padia e ngritur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër duhet pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

Rezulton se paditësi-DRT Dibër, ka goditur gjyqësish vendimin nr. 30367/4 Prot, datë 03.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, për pjesën që ka shfuqizuar "Njoftim vlerësimi tatimor nr. 7064 Prot, datë 16.10.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër", nëpërmjet të cilit është ndryshuar vlerësimi tatimor duke pakësuar detyrimet e përcaktuar për shoqërinë "Qendra Balneare" për zërin "Tatimi Fitim" për vitet 2009, 2010, 2011, si dhe "Tatim i mbajtur në Burim".

Së pari: Pala paditëse në ankimin e saj ka parashtuar se: Gjykata gjatë gjykimit nuk ka bërë një hetim të plotë të fakteve, por është mjaftuar në përmbajtjen e pjesës arsyetuese të DAT Tiranë dhe se pala e paditur nuk provon pretendimet e saj në lidhje me detyrën e agentit tatimor për vjeljen e tarifës së "larjes". Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim i palës paditëse është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të pranohet. Në shqyrtim të akteve të dosjes gjyqësore si dhe në shqyrtim të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se nuk janë paraqitur në cilësinë e provës aktet mbi të cilat gjykata ka mbështetur arsyetimin e saj. Gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka përcaktuar se subjekti nuk ka siguruar të ardhura, nga vjelja e tarifës së "larjes" për shkak se ato janë mbledhur në interes të Bashkisë Peshkopi.

Në arsyetimin e saj Gjykata Administrative e Apelit i referohet ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" në pikës 3 të nenit 16 "Të ardhurat e veta të komunës dhe të bashkisë", përcaktohet se :

3. Komuna dhe bashkia krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;

c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë.

Ndërsa në ligjit nr. 9632, datë 31.07.2000 "Për sistemin e taksave vendore" nenin 35 "Tarifat vendore dhe administrimi i tyre" përcaktohet se:

1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore";

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.

Në referim të dispozitave të sipërcituar përcaktohet se kryetari i bashkisë dhe komunës ka të drejtë të përcaktojë llojin e tarifave, nivelin e tyre si dhe rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre. Në këto kushte nëse "Tarifa e larjes" do të ishte e përcaktuar nga Kryetari i Bashkisë, detyrimisht duhet të ishin përcaktuar dhe strukturat përgjegjëse për mbledhjen e këtyre tarifave. Në interpretim të dispozitave të sipërcituara vjelja e tarifave vendore kërkon një rregullim të posaçëm sipas përcaktimeve ligjore të cilat konsistojnë në angazhimin e strukturave të veçanta të bashkisë apo komunës ose kryerja e këtij shërbimi me agjent.

Në rastin objekt gjykimi pala e paditur DAT Tiranë ka prapësuar se shoqëria Qendra Balneare është cilësuar si agjent për mbledhjen dhe vjeljen e tarifës së "Larjes" kjo sipas marrëveshjes së nënshkruar midis Qendrës Balneare Peshkopi dhe Bashkisë Peshkopi. Gjatë gjykimit në apel u konstatua se në aktet e depozituara në dosjen gjyqësore nuk ka të administruar asnjë marrëveshje apo vendim të Këshillit Bashkiak, për përcaktimin e tarifës së "Larjes". Gjykata në kushtet e mungesë së këtij akti si dhe në kushtet e zhvillimit të një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, në seancën gjyqësore të datës 23.03.2016 ka vendosur që ti kërkojë informacion Bashkisë Peshkopi, për të saktësuar statusin juridik që ka ky autoritet më Qendrën Balneare. Në vijim gjykata në kushtet e mos marrjes së informacionit nga Bashkia Peshkopi ka vendosur në seancën gjyqësore të datës 14.04.2016 të përsëris kërkesën e saj për informacion. Nuk rezulton të jetë kthyer asnjë përgjigje nga Bashkia Peshkopi.

Pala paditëse DRT Dibër në ankimin e saj ka parashtruar se: Qendra Balneare nuk ka dokumentuar mënyrën dhe mbledhjen e kësaj tarife, por vetëm pretendon se diferenca në llogarite bankare për vitin 2009, 2010 dhe 2011 janë si pasojë e vjeljes së tarifës së larjes. Gjykata Administrative e Apelit çmon se ky pretendim i palës së paditur është i bazuar në ligj dhe në prova e si i tillë duhet të pranohet.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të gabuar çështjen e tatim fitimit në rastin konkret.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se DAT Tiranë dhe gjykata e shkallës së parë ka keqinterpretuar dispozitat ligjore të cilat rregullojnë raportet në lidhje me trajtimin e pagesave të tatim fitimit.

Në nenin 19 të ligjit 8438, datë 28.12.1998 "për tatimin mbi të ardhurat", përcaktohet se: "fitimi i tatueshëm përcaktohet në bilanc ose dhe në anekset e tij të cilat duhet të jenë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ndërsa sipas përcaktimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 8, përcaktohet se:

"Shuma e mbledhur në emër të palëve të treta, të tilla si tatimi mbi vlerën e shtuar nuk janë të ardhura".

Bazuar në këto përcaktime ligjore, Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi: nuk u provua që diferencat e konstatuara në llogaritë bankare të subjektit Qendra Balneare janë shumat e tarifave të mbledhura për Bashkinë Peshkopi, sikurse u argumentua më lartë,

Së dytë: nuk rezulton që qendra të ketë një dokument kontabël të përpiluar ku të jenë pasqyruar të dhënat e vjeljes së kësaj tarife. Nuk u provua gjatë gjykimit mënyra e menaxhimit të vjeljes së kësaj tarife, arkëtimi i tyre apo transferimi bankar i këtyre shumave në interes të Bashkisë Peshkopi, ky në cilësinë e autoritetit që përcakton llojin dhe masën e tarifave vendore.

Për sa më lartë gjykata vlerëson se diferenca midis deklarimeve të subjektit dhe të hyrave në llogaritë bankare do të konsiderohen si të ardhura të padeklaruara, ashtu siç me të drejtë ka vepruar dhe DRT Dibër në vlerësimin tatimor. Gjithashtu rezulton që për këto të ardhura të pajustificuara dhe të padokumentuara, për të cilat nuk rezulton të jetë lëshuar fatura tatimore, sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor të aplikueshëm, në referim të nenit 124 të ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" subjekti dënohet me gjobë të barabartë me 100 % të detyrimit tatimor.

Së dyti: Paditësi në ankimin e tij kundërshton qëndrimin e mbajtur nga gjykata në lidhje me vlerësimin që i bëhet tatimit në burim për vlerën e të ardhurave 8.030.636, për të cilat nga shoqëria Qendra Balneare nuk rezulton të jetë mbajtur tatim në burim.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë u provua se shoqëria ka shtuar zërin ndërtesë për vitin 2009, por nuk ka deklaruar shtimin e zërit ndërtesë, kjo sipas pasqyrit në bilanc. Gjithashtu nga aktet e depozituara në dosje nuk janë paraqitur fatura apo autofatura që kanë të bëjnë me kryerjen e investimit. Në këto kushte gjykata çmon se vlerësimi i kryer nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë se shumën e tërhequr 8,030,636 lekë nga pala e paditur

Qëndar Balneare, është kryer për efekt rikonstruksion objektit, nuk provohet e si e tillë ky qëndrim është i gabuar.

Në arsyetimin e saj gjykata i referohet përcaktimeve të nenit 33/1 "Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit të ligjit 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", në të cilin përcaktohet se:

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

Referuar provave të administruara në gjykim, rezulton se subjekti Qendra Balneare Peshkopi, Asambleja e Ortakëve, nuk ka marrë ndonjë vendim për të përcaktuar destinacionin e të ardhurave. Në këto kushte pretendimi i subjektit se vlera 8,380,000 lekë do të kalonte për rikonstruksionin e kompleksit (e cila në vlerën e preventivit është në shumën 23,119,200.00 lekë), është një pretendim i pabazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë i papranueshëm.

Veç sa më sipër, vendimi i pretenduar nga pala e paditur Qendra Balneare Peshkopi, nuk rezulton të jetë paraqitur përpara organit tatimor sipas përcaktimeve të nenit 33/1 të Ligjit "Për Tatimin mbi të Ardhurat". Në nenin 33/1 të titulluar "Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit" përcaktohet:

Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë/vendimi i personit fizik, sipas këtij neni, për miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni.

Për sa më lartë sikurse dhe në interpretim të kësaj dispozite rezulton se në rast se shoqëria nuk ka kryer dhënien e destinacionit të fitimit të përcaktuar në tre drejtime, shumën e rezervave ligjor, pjesën për investime apo shtesën e kapitalit apo shpërndarjen e dividendëve, atëherë ndodh që organi tatimor të kryej vetë vlerësimin. Në këto kushte DRT Dibër, ka përcaktuar llogaritjen e tatimit të burim për të ardhurat në shumën 8,030,636 lekë. Së bashku me tatim burimin në masën 10 % të vlerës është llogaritur dhe gjoba në masën 200,766 lekë duke rezultuar në një detyrim total 1, 243,946 lekë.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit në seancë gjyqësore nga pala e paditur Qendra Balneare dhe DAT Tiranë nuk janë paraqitur në cilësinë e provës fatura apo autofatura të cilat do të provonin kryerjen e investimit për rikonstruksionin e objektit.

Në këto rrethana nuk u arrit të provohej dokumentimi i bashkëpunimit midis sipërmarrësit dhe Qendrës Balneare, për kryerjen e punimeve, gjithashtu nuk u provua që subjekti sipërmarrës, i kontraktuar për kryerjen e punimeve të ketë dokumentuar punën e tij me gjenerimin e faturave tatimore gjatë periudhës 2008 – 2009, si dhe pasqyrimin e tyre në dokumentat financiar të njohur nga ligji shqiptar.

Në analizë të provave të administruara në gjykim si dhe përcaktimeve të ligjit gjykata çmon se pretendimet e ngritura në ankim nga pala paditëse DRT Dibër janë të themelta e si të tilla

ato duhet të pranohen dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të ndryshohet.

Për sa më lartë, Gjykata Administrative e Apelit çmon se padia e paditësit DRT Dibër është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet të pranohet dhe vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor duhet të shfuqizohet si i pabazuar në prova dhe në ligj.

Në konkluzion të sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 53 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr. 4087, datë 20.07.2015 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të ndryshohet dhe padia e paditësit DRT Dibër duhet të pranohet, si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 53 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

1. Ndryshimin e vendimit nr. 4087 datë 20.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Pranimin e padisë.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 30367/4 Prot datë 03.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, për pjesën që ka shfuqizuar "Njoftim vlerësimi tatimor nr. 7064 Prot, datë 16.10.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër".
4. Shepnzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmyja e shpalljes ose marrjes dijeni për palën në mungesë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 06.05.2016.

GJYQTAR
Rilinda SELIMI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njësia me origjinalin

Kancelari
Leonard Steadly
Steadly